



AKT THEMELIMI

I SHOQERISE "DRANOVA" SH.P.K.

I nenshkruari Hazir Gashi, i biri i Sadriut, dtl. 1951, lindur e banues ne Durres Plazh, rruga Vasil Kondi, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise,

V E N D O S A :

- Krijimin e shoqerise " DRANOVA" shpk e cila ka objekt te veprimtarise se saj ne fushen e ndertimeve, si dhe te prodhimeve te materiale te ndertimit ndertimi, ndertime civile nje e shume kate, vila, objekte industriale, instalimet elektrike dhe hidraulike te tyre, ndertime te objekteve fetare si xhami e kisha, restaurime te objekteve te ndryshme, per parafabrikatesh dhe elementesh te paratensionuar, makineri ndertimi, pjese kembimi, si dhe punime te te gjitha llojeve, ne fushen e tregtimit e mallrave te ndryshme industriale dhe ushqimore me shumice e pakice, elektroshteplake, materiale ndertimi, bime medicinale.
- Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.
- Administrator i shoqerise eshte Hazir Gashi, i biri i Sadriut, dtl. 1951, lindur e banues ne Durres Plazh, rruga Vasil Kondi.
- Qendra e shoqerise eshte ne Durres Plazh, rruga Vasil Kondi
- Jetegjatesia e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

ORTAKU I VETEM

/ HAZIR GASHI /

STATUT

I SHOQERISE "DRANOVA" SH.P.K.

KAPITALI THEMELTAR : 100.000 leke
ORTAKU I VETEM : HAZIR GASHI

KREU I

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, QENDRA, JETEGJATESIA

NENI 1

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.08.1991 " Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarive private, te pavarura dhe privatizimit" dhe ligjes nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" ortakut i vetem Hazir Gashi, me vullnetin e tij te lire krijon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "DRANOVA" shpk,

Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe normat e akteve te saj themeluese.

Shoqeria pergjigjet perpara te treteve me kapitalin e saj themeltar, deri ne kufi te ketij te fundit.

NENI 2

Shoqeria ka objekt te veprimtarise se saj ne fushen e ndertimeve, si dhe materiale ndertimi, ndertime civile nje e shume kate, vila, objekte industriale, instalimet elektrike dhe hidraulike te tyre, ndertime te objekteve fetare si xhami e kisha, restaurime te objekteve te ndryshme, per parafabrikatesh dhe elementesh te paratensionuar, makineri ndertimi, pjese kembimi, si dhe punime te te gjitha llojeve, ne fushen e tregtimit e mallrave te ndryshme industriale dhe ushqimore me shumice e pakice, elektroshtepiake, materiale ndertimi, bime medicinale.



NENI 3

Shoqeria e ka qendren ne Durres, Plazh, rruga Vasil Kondi.

Me vendimin e saj shoqeria mund te krijojte qendra dytesore, si filiale, agjenci apo perfaqesi.

NENI 4

Jetegjatesia e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Me vendim te ortakut te vetem apo kur verifikohen rrethana te tilla, kur shperndarja e shoqerise urdherohet shprehimisht nga ligja, shoqeria mund te shperndarhet perpara ketij afati.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqreise eshte 100.000 leke.

Ai i perket teresisht ortakut te vetem, eshte nenshkruar e shlyer prej teresisht ne para.

Me vendim te ortakut te vetem, i cili reegjistrohet ne Librin e Shoqerise, kapitali mund te ndryshohet.

Kapitali themeltar i shoqerise nuk mund te perfaqesohet ne letra me vlere te tregtueshme apo sherbime.

NENI 6

Kapitali themeltar eshte i ndare ne kuota nga 1000 leke secila. Per transferimin e tyre ne cdo forme apo tek cdo subjekt kompetent eshte ortaku i vetem.

NENI 7

Shoqeria ka te drejte te lere peng nje pjese te kapitalit te saj themeltar. Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person te cilit i jane transferuar pjese te kapitalit themeltar me perjashtim te rasteve kur shoqeria preferon t'i riblejte keto pjese e te deklarroje zvogelimin e mundshem te kapitalit te saj themeltar.



KREU III

ORGANET E SHOQERISE, ADMINISTRIMI

NENI 8

Ortakut i vetem eshte organi me i larte i shoqerise. Atij i takojne kompetencat qe ne ligjen "Per shoqerite trgtare" i jane dhene Asamblese se Ortakeve.

Vendimet e ortakut te vetem regjistrohen ne Librin e Shoqerise.

Neni 9

Cdo i interesuar mund te kerkoje ne Gjykaten e Rrethit Tirane anullimin e vendimeve te ortakut te vetem te marra ne kundershtim me dispozitat ligjore dhe normat e ketij statuti.

NENI 10

Shoqeria administrohet nga nje administrator i cili eshte Hazir Gashi, i biri i Sadriut, dtl. 1951, lindur e banues ne Durres Plazh, rruga Vasil Kondi.

NENI 11

Administratori ka te drejte te kryeje cdo veprim administrimi ne interes te shoqerise, brenda objektit te saj te veprimtarise.

NENI 12

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit edhe kur keto nuk perfshihen ne objektin e veprimtarise se shoqerise, apo kur te tretet ne rrethana te caktuara nuk mund ta injoronin kete fakt.

NENI 13

Administratorit i takon firma dhe perfaqesimi i shoqerise.

ADMINISTRATORI I SHOQERISE
Hazir Gashi

